# DËSHMI ARKIVI

**A-439055**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dehje më e shpejtë? Temperaturat e larta ndikojnë edhe te shampanja, autoritete franceze autorizojnë prodhimin e saj me përqindje më të lartë alkooli |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/12/temperaturat-e-larta-ndikojne-edhe-te-shampanja-autoritete-franceze-autorizojne-prodhimin-e-saj-me-perqindje-me-te-larte-alkooli645646/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 20:52:22 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 12 shtator 2026, 20:49:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 12 shtator 2026, 20:48:00 UTC → 12 shtator 2026, 20:50:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c0d01bd60dc673d55ee2170abe0775cf2202dc1f5ff1116f3652e887a405a7f5` |
| TEKSTI | `71ab0165c51cf299993b196efed80874f53b69e262bc08e081b1240cfee2559b` |
| PAMJA | `4bbef84cb16bf193485c50756a234d37e97769e95cd15fe721e3a32a7db36f38` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `13b22f3102f4a6d46b91a5689f2edc5f2f181b007adc428294e292d86e166a95` |
| E MËPARSHMJA | `88c04568c06b123d2534a2eb9f20195f893b6c032bdd6e441ce20ab0a1e9d612` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/13b22f3102f4a6d46b91a5689f2edc5f2f181b007adc428294e292d86e166a95`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Dehje më e shpejtë? Temperaturat e larta ndikojnë edhe te shampanja, autoritete franceze autorizojnë prodhimin e saj me përqindje më të lartë alkooli

12/09/2026 22:49

Dashamirësit e shampanjës mund të 'dehen' më shpejt, pasi prodhuesit francezë janë autorizuar për herë të parë të rrisin përkohësisht përqindjen e alkoolit në pijet e gazuara.

Prodhuesit në rajonin e Shampanjës mund të prodhojnë këtë vit shampanjë me deri në 15% alkool, mbi kufirin e mëparshëm prej 13%.

Vendimi vjen pas një vere me temperatura rekord dhe thatësirë, të cilat kanë bërë që rrushi të ketë nivele jashtëzakonisht të larta sheqeri. Gjatë fermentimit, majaja e shndërron sheqerin në alkool.

Rajoni i Shampanjës pati gjithashtu korrjen më të hershme të regjistruar ndonjëherë. Sipas shoqatës së industrisë Comite Champagne, ndryshimet klimatike mund ta bëjnë këtë situatë normale brenda 10 deri në 15 viteve.

Megjithatë, rritja e përqindjes së alkoolit pritet të prekë vetëm një numër të vogël verërash. Gjatë fermentimit të dytë, që i jep shampanjës gazin, disa prej tyre mund të kenë kaluar pak kufirin prej 13%, duke arritur rreth 13.1% ose 13.2%.

Për këtë arsye, kufiri është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme dhe vetëm për vitin 2026, deri në 15%.

Sezoni i këtij viti është përshkruar si një nga më të pazakontët në historinë e rajonit, me ngrica të forta në pranverë, lulëzim të hershëm dhe pesë valë të nxehti gjatë verës.

Ekspertët paralajmërojnë se shampanja me përqindje më të lartë alkooli mund të mos jetë domosdoshmërisht avantazh në treg, pasi konsumatorët po orientohen gjithnjë e më shumë drejt pijeve me më pak alkool.

Shampanja e prodhuar nga rrushi i vitit 2026 nuk pritet të dalë në treg para vitit 2028, pasi ajo duhet të maturohet për të paktën 15 muaj.

Maxime Toubart, bashkëkryetar i Comite Champagne, tha se temperaturat më të larta në të ardhmen mund ta bëjnë korrjen e pazakontë të këtij viti një dukuri normale brenda 10 deri në 15 viteve.

Ndryshimet klimatike po rrisin temperaturat mesatare globale dhe po i bëjnë valët e të nxehtit më të shpeshta dhe më intensive. Evropa është ndër rajonet që po ngrohet më shpejt, me ritëm rreth dy herë më të lartë se mesatarja globale.

Top Channel

Bota »

Kriza me emigracionin në Ceuta/ Autoritetet spanjolle publikojnë shifrat, 13 mijë të bllokuar, 2 mijë prej tyre të mitur
12/09 22:57

Vdekja e Mazonakis/ Ngrihet alarmi nga mjekët, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë alternative, informohuni për…
12/09 21:30

Panik në Bruksel/ Droni i panjohur pikaset në hapësirën ajrore të aeroportit të kryeqytetit belg, ndërpriten uljet dhe ngritjet për 30 minuta
12/09 21:25

Tragjedi në Kili, azili i të moshuarve përfshihet nga flakët, humbin jetën 16 persona
12/09 19:15

"Nëse Zelensky do takim, të vijë në Moskë", zëdhënësi i Kremlinit: Pjesëmarrja e Putin në samitin e G20 në Miami nuk është vendosur ende
12/09 18:12

Anthropic në listën e zezë të SHBA, Trump: AI, jo kërcënim ekzistencial për njerëzimin
12/09 16:45

Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel

Video »

Top Channel/ Tritol mësuesit në Shkodër, dyshohet mesazh për të vëllanë

Top Channel/ Diaspora "zbarkon" në Tiranë, mijëra qytetarë mbushin bulevardin "Dëshmorët e Kombit"

Top Channel/ Mbyllet tubimi në bulevard, protestuesit rrethojnë simbolikisht Kryeministrinë

Lajmet kryesore të ditës – Top News, 12 Shtator 2026

Top News-E shkuara e errët e Lulzim Cakës, u arrestua në Greqi, në Shqipëri kërkohej për disa vrasje

Top Channel/ Protestë në Bronx për liderët e UÇK-së në Hagë, Hajdari: Kërkojmë drejtësi jo mëshirë

Kryesore

SPAK sërish para Kuvendit për masë sigurie ndaj Ballukut? Akuzat e reja ndaj ish-zv. kryeministres rikthejnë debatin për një kërkesë të dytë në Parlament
19:54

"E duan rritjen që nga prilli 2023"/ Rama për vendimin e Gjykatës Administrative: "Prapambetjet" e pagave për gjyqtarët shkojnë në 130.5 milionë euro
16:04

U arrestua në Greqi si kreu i bandës së kokainës, kush është "i tmerrshmi i Beratit", saga e krimeve që akuzohet në Shqipëri dhe arratisjet nga burgu
21:33

Ambulanca përplas të moshuarin në Korçë, shoferi ishte i dehur e çon vetë në spital
09:27

Tritol banesës së mësuesit në Shkodër, zbulohet emri i pronarit të shtëpisë
22:22

Më të lexuarat

BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së: Respektoni verdiktin e Speciales, nuk është përfundimtar
Arratisje spektakolare në Greqi! Bashkëpunëtorët i bënë pritë me kallashnikov, zbulohet identiteti i të burgosurit shqiptar
"Veliaj në burg, absurd i kryeqytetit", Rama për hetimet ndaj Belinda Ballukut: Nuk e mbron askush, çështjen e ka me drejtësinë
U dhunua shtatzënë gjatë grabitjes, humbi fëmijën, 9 vite burg për "trurin" e sulmit ndaj Donnarummës dhe partneres së tij
Nuk ka "fund" droga e sekuestruar e "të tmerrshmit të Beratit", gjenden edhe 26 kg kokainë në banesën e Lulëzim Cakës, vendi ku e fshihte
Vdekja e Mazonakis/ Ngrihet alarmi nga mjekët, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë alternative, informohuni për…
Video/ Pamje emocionuese, prezantuesja e Top Channel zbulon sekretin e ëmbël, në pritje të fëmijës së parë
Ndalimi i shqiptarëve në Mal të Zi për simbolet kombëtare, reagon ministri Dukaj: Flamuri shqiptar nuk është kërcënim
U arrestua në Greqi si kreu i bandës së kokainës, kush është "i tmerrshmi i Beratit", saga e krimeve që akuzohet në Shqipëri dhe arratisjet nga burgu
U arratis nga spitali grek, zbulohen fotot e të dënuarit Gentian Çipit, ja si duket ai sot

- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.